



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.135/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rustem Thaqi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A., me seli në P., kundër debitorit "K." me adresë ... p.n në S., me bazë përmbarimi, sipas titullit ekzekutiv, duke vendosur lidhur me kompetencën lëndore, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.03.2024, merr këtë:

AKTVENDIM

Për gjykim në çështjen juridike – përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A., me seli në P., kundër debitorit "K." me adresë p.n në S., kompetente lëndore është Gjykata Themelore në Prizren –Dega në Suharekë, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

Arsyetimi

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, me aktvendimin E.nr. 439/2016, të datës 06.10.2016, ka lejuar ekzekutimin e titullit përmbarimor për pagesën e borxhit në shumë prej 358.82 €. Pastaj me aktvendimin CP.nr.439/16, të datës 20.01.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike. Kjo gjykatë, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i përmbarimit, nuk është kompetencë lëndore e saj , por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, me aktvendimin e vet, KPPP.nr. 279/23, të datës 22.02.2024, ka hapur konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti

për Çështje Ekonomike, dhe Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, duke konsideruar se nuk kemi të bëjmë me kompetencë të Gjykatës Komerciale por kemi të bëjmë me përmbartimin e dokumentit në lejin e të cilit nuk ka asnjë mjet për tu shqyrtuar, dhe gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt për vendosjen kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë.

Në bazë të nenit 25 paragraf 2 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 paragraf 1, të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr.06/L-054 i datës 23.11.2018, konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të ndryshëm e zgjidhë Gjykata Supreme e Kosovës. Në këtë rast Gjykata e Supreme e Kosovës, si gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt ka kompetencë lidhur me zgjidhjen e konfliktit të kompetencës.

Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: “ Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate ”.

Me qenë se nuk kemi të bëjmë me mjetet juridike në procedurë përmbartimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje: LPP) janë te përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: "Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa," ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen se mjetet e jashtëzakonshme nuk lejohen përveç kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në raste të parapara me ligj, duke u nisur nga fakti se në rastin konkret, lënda ka për objekt zbatimin e përmbartimit sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbartimore Gjykata Komerciale nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Themelore në Prizren –Dega në Suharekë, për faktin se palët në këtë çështje përmbartimore, pasi që është lejuar përmbartimi, lënda ka qenë në gjykatën themelore dhe nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejin e përmbartimit, ndërsa

kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kaloj te përmbaruesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP, andaj Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e LPP-së. Në rastet kur kemi të bëjmë me zbatimin e përmbarimit sipas propozimit të kreditorit në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, sepse e njëjta vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit të përmbarimit dhe në rastin kur palët nuk kanë paraqitur mjet juridik (prapsim apo ankesë), në të gjitha këto raste kompetente për të gjykuar janë gjykatat themelore, varësisht prej kompetencës territoriale.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbarimore, atëherë kjo çështje përmbarimore do të ishte në kompetencë të Gjykatës Komerciale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuar sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale të cekur më lart, sepse Gjykata Komerciale ka kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur sipas padisë se paditësve është Gjykata Themelore në Prizren –Dega në Suharekë, në pajtim me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 06/L - 054 për gjykatat, i cili përcakton se "Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe". Prandaj për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.135/2024 datë 21.03.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami